A3 _ DRAFT KONTRATË PUNIMESH

Nr. i Referencës së Kontratës: <numër>

<Emri i plotë dhe adresa e autoritetit kontraktor>

("Autoriteti kontraktor"),

nga njëra palë,

dhe

<Emri i plotë zyrtar i kontraktorit>
<Adresa e plotë zyrtare>
<Numri i NIPT-it>
<Përfaqësuesi i autorizuar>, ("kontraktori")

nga pala tjetër,

kanë rënë dakord si më poshtë:

KONTRATE

Neni 1: Objekti

1.1. Objekti i kontratës do të jetë realizimi i punimeve siç përshkruhen në Specifikimet Teknike (Aneksi III) bashkëlidhur kësaj kontrate.

Neni 2: Periudha dhe kushtet

2.1. Periudha e zbatimit të punimeve/detyrave do të jetë <numër> ditë kalendarike duke filluar nga nënshkrimi i kontratës.

2.2. Kontraktori do të respektojë në mënyrë strikte kushtet e specifikimeve teknike (Aneksi III) dhe ofertës teknike (Aneksi IV).

2.3. Në konsideratë të pagesave që duhet të bëhen nga autoriteti kontraktues për kontraktorin, siç përmendet më poshtë, kontraktori merr përsipër të ekzekutojë dhe përfundojë punimet dhe të korrigjojë defektet në to në përputhje të plotë me dispozitat e kontratës.

Neni 3: Çmimi

3.1 Çmimi i kontratës do të jetë ai i paraqitur në ofertën financiare (Aneksi V). Çmimi maksimal total i kontratës do të jetë EUR <shuma>, përfshirë të gjitha taksat dhe detyrimet e aplikueshme.

3.2 Pagesat do të kryhen në euro (EUR), në përputhje me nenet 26 deri 28 të Kushteve të Përgjithshme dhe Kushteve të Veçanta.

Neni 4: Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1. Kontrata përbëhet nga dokumentet e mëposhtme, sipas rendit të përparësisë:

- dokumenti i kontratës;
- kushtet e veçanta (Aneksi I);
- kushtet e përgjithshme (Aneksi II);
- specifikimet teknike (Aneksi III);
- oferta teknike e kontraktorit (Aneksi IV);
- oferta financiare e kontraktorit (Aneksi V);
- formularët përkatës dhe dokumentet e tjera (Aneksi VI);

4.2. Dokumentet e ndryshme që përbëjnë kontratën do të konsiderohen se shpjegojnë reciprokisht njëri-tjetrin; në rast paqartësie ose mospërputhjeje, do të mbizotërojnë sipas rendit në të cilin paraqiten më sipër.

Neni 5: Kushtet specifike të zbatueshme për kontratën

5.1. Çdo komunikim me shkrim ndërmjet Palëve do të jetë në anglisht ose shqip dhe do t'u dërgohet personave të kontaktit dhe në të dhënat e kontaktit të përcaktuara më poshtë:

Për autoritetin kontraktor	**Për kontraktorin**
<Emri i autoritetit kontraktor>	<Emri i kontraktorit>
<Adresa e autoritetit kontraktor>	<Adresa e kontraktorit>
<Emri i përfaqësuesit të autorizuar>	<Emri i përfaqësuesit të autorizuar>
<Email-i i përfaqësuesit të autorizuar>	<Email-i i përfaqësuesit të autorizuar>
<Telefoni i përfaqësuesit të autorizuar>	<Telefoni i përfaqësuesit të autorizuar>

5.2. Kushtet e tjera të veçanta të zbatueshme për kontratën do të jenë ato të përcaktuara në Aneksin I bashkëlidhur.

Neni 6: Dispozita të tjera

6.1. Kjo marrëveshje do të rregullohet nga legjislacioni shqiptar, marrëveshja përkatëse e financimit dhe rregulloret/udhëzimet e brendshme të YSBB-së.

6.2. Anekset e mëposhtme të Kontratës do të përbëjnë pjesë përbërëse të saj:

Aneksi I - kushtet e veçanta;
Aneksi II - kushtet e përgjithshme;
Aneksi III - specifikimet teknike;
Aneksi IV - oferta teknike;
Aneksi V - oferta financiare;
Aneksi VI - formularët dhe dokumentet e tjera.

***

Kjo Kontratë përgatitet në dy kopje, një për autoritetin kontraktor dhe një për kontraktorin.

***

Për autoritetin kontraktor	**Për kontraktorin**
Emri: _____	Emri: _____
Pozicioni: _____	Pozicioni: _____
Firma: _____	Firma: _____
Data: _____	Data: _____